



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.427/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Nexhmedin Spahiu, kandidat për kryetar të Komunës së Mitrovicës, nga subjekti politik Të Pavarurit e Mitrovicës, për shkak të dëmtimit të posterave, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Nexhmedin Spahiu, kandidat për kryetar të Komunës së Mitrovicës, nga subjekti politik Të Pavarurit e Mitrovicës.

Arsyetim

PZAP-i, me datën 02.11.2013 ka pranuar ankesë nga kandidati për kryetar të Komunës së Mitrovicës, Nexhmedin Spahiu, nga radhët e subjektit politik Të Pavarurit e Mitrovicës, në të cilën theksohet se panot e tij janë të vendosura në domenin e kamerave të policisë të sheshi Isa Boletini dhe të sheshi i Mehë Uka, dhe janë të vetmet në Mitrovicë të cilat po grisen dhe e po përdhosen çdo ditë, ku rastin e fundit parashtruesi i ankesës thekson se e ka zbuluar vetë e ky është Egzon Smajli, militant i PDK-së, banor i lagjes Bair, rruga Afrim Hajrizi, i cili me shokët e tij shqeu panon të sheshi Isa Boletini. Parashtruesi i ankesës kërkon nga Policia e Kosovës që përmes regjistrimit të kamerave të zbardhë identitetin edhe të keqbërve të tjerë dhe të panos së tij edhe herave të tjera të sheshi Isa Boletini dhe sheshi Mehë Uka.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pala e interesuar mund të ofroj dëshmi apo fakte të reja në PZAP, në bazë të nenit 118.4 të LZP-së dhe PZAP-i mund ta rishikojë prapë vendimin e tij ngase sipas nenit 6.8 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it parashihet së: *“Përgjegjësia për dhënien e dëshmisë është në anën e palës ankuese”* ngase me ankesën e parashtruar nga Nexhmedin Spahiu Anr. 427/2013 të datës 02.11.2013, në cilësinë e kandidat për kryetar të Mitrovicës nga *“Të Pavarurit e Mitrovicës”*, në të cilën pretendohet se janë grisur panot e tij në sheshin Isa Boletini dhe sheshin Mehë Uka, nuk janë ofruar dëshmi që do të ndikonin për të marr ndonjë vendim ndryshe.

PZAP-i, duke u bazuar në arsyet theksuar më lart konstatoi se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë ngase dëshmitë e ofruar nuk janë të asaj natyre që do të vërtetonin se Egzon Smajli militant i subjektit politik PDK, është përgjegjës për pretendimet e theksuara në ankesë, sepse vetëm është përmendur emri i personit në fjalë nga parashtruesi i ankesës për dëmtimin e posterave të tij, mirëpo nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me këtë pretendim.

Bazuar në nenin 118.1 të LZP-së, në të cilin parashihet se: *“PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet”*, PZAP-i vendosi në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 427/2013 më datën 07.11.2013.

Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala

Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.